

VENDIM
Nr. 1039, datë 4.12.2013

**PËR FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË PUNËS DHE PËR CAKTIMIN
E PËRFAQËSUESVE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NË KËTË KËSHILL**

(ndryshuar me VKM nr.84, datë 14.2.2018, nr. 54, datë 29.1.2020, nr. 265, datë 27.4.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 200 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli Kombëtar i Punës, në vijim KKP, është organ konsultativ trepalësh me përfaqëues të Këshillit të Ministrave dhe të organizatave të punëdhënësve e të punëmarrësve.

2. KKP-ja zhvillon këshillime, merr vendime me konsensus dhe i bën rekomandimet përkatëse Këshillit të Ministrave, nëpërmjet *ministrit përgjegjës për punën*.

3. Organizatat e punëdhënësve e të punëmarrësve, si dhe administrata publike duhet t'i vënë në dispozicion KKP-së, sipas kërkesës, të gjitha informacionet dhe të dhënat e nevojshme, që kanë lidhje me objektin e funksionimit të këtij Këshilli, për zhvillimin e këshillimeve.

4. KKP-ja kryesohet nga ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe ka në përbërje, si përfaqësues të Këshillit të Ministrave, këta anëtarë:

- Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministrin e Drejtësisë;
- Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

Përfaqësues, kandidatë të KKP-së, në mungesë të përfaqësuesve, anëtarë të Këshillit të Ministrave, janë zëvendësministrat përkatës.

4/1. Përfaqësimi i organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve në Këshillin Kombëtar të Punës përcaktohet sipas kriterëve të mëposhtme:

a) për organizatat e punëmarrësve (konfederata, federata, sindikata):

i. personalitet juridik, sipas legjislacionit në fuqi, prej më shumë se 2 (dy) vjetësh;

ii. pavarësi organizative e financiare;

iii. shtrirje territoriale në të paktën 50 (pesëdhjetë) % të qarqeve të vendit, përfshirë dhe qarkun e Tiranës;

iv. strukturë administrative për të përmbushur detyrimet ligjore të partneritetit social;

v. numri i përgjithshëm i anëtarëve në konfederatë të jetë jo më pak se 5 (pesë) % e numrit të përgjithshëm të punëmarrësve në shkallë vendi, por jo më pak se 20 000 (njëzet mijë) anëtarë; ndërsa për federatat dhe sindikatat, numri i përgjithshëm i anëtarëve në shkallë vendi të jetë jo më pak se 5 (pesë) % e numrit të punëmarrësve në degën/profesionin përkatës;

vi. numri i kontratave kolektive, si dhe numri i përgjithshëm i punëmarrësve të mbuluar me kontrata kolektive;

vii. anëtarësimi në organizata ndërkombëtare të punëmarrësve.

b) Për organizatat e punëdhënësve:

- i. personalitet juridik, sipas legjislacionit në fuqi, prej më shumë se 2 (dy) vjetësh;*
- ii. pavarësi organizative e financiare;*
- iii. shtrirje territoriale në të paktën 50 (pesëdhjetë) % të qarqeve të vendit, përfshirë dhe qarkun e Tiranës;*
- iv. strukturë administrative për të përmbushur detyrimet ligjore të partneritetit social;*
- v. numri i anëtarëve që punësojnë të jetë jo më pak se 5 (pesë) % e numrit të punëmarrësve në degën/profesionin përkatës;*
- vi. numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të anëtarësuar, i cili nuk mund të jetë më i vogël se 10 (dhjetë) % nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB);*
- vii. anëtarësimi në organizata ndërkombëtare të punëdhënësve.*

5. Kryetari i KKP-së ka këto detyra:

- a) të drejtojë mbledhjet e KKP-së;
- b) të miratojë rendin e ditës, raportin përfundimtar të mbledhjeve, si dhe programin vjetor të këtij Këshilli, pas mirëkuptimit me palët;
- c) të informojë Këshillin e Ministrave për rekomandimet e këtij Këshilli, si dhe për mendimet e organizatave të punëdhënësve e të punëmarrësve.

6. Përfaqësuesit e organizatave të punëdhënësve e të punëmarrësve, anëtarë të KKP-së, caktojnë përkatësisht kryetarët e këtyre dy palëve, të cilët janë edhe nënkryetarë të KKP-së.

7. KKP-ja mbledhet në përputhje me programin e miratuar prej tij ose me kërkesën me shkrim të çdo pale, drejtuar kryetarit të Këshillit, sipas përcaktimit të bërë në rregulloren e brendshme të funksionimit.

8. Anëtarët e KKP-së, për çështjet që do të diskutohen, kanë të drejtën e këshillimit paraprak dhe e shprehin qëndrimin e tyre nëpërmjet kryetarit të palës ose anëtarit të ngarkuar nga kryetari përkatës, për çështje specifike.

9. Pranë KKP-së krijohen dhe funksionojnë komisionet e përhershme e të specializuara tripalëshe, me përbërje, si më poshtë vijon:

a) Komisioni juridik kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:

i. Ministria e Drejtësisë;

ii. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH);

iii. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH);

iv. Biznesalbania;

v. shoqata "Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë".

b) Komisioni i punësimit, arsimit dhe formimit profesional kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Punësimit, Arsimit dhe Formimit Profesional në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:

i. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përgjegjës sektori i PAFP-së;

ii. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH);

iii. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH);

iv. Biznesalbania;

v. Shoqata e Bukës, Pastërisë dhe Brumërave.

c) Komisioni i pagave, pensione dhe përkrahjes sociale kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Pensioneve dhe Pagës Minimale në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:

i. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit;

ii. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH);

iii. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH);

iv. Biznesalbania;

v. Dhoma Kombëtare e Prodhuesve të Veshjeve/Këpucëve-Proeksport.

c) Komisioni i kushteve të punës, shëndetit dhe sigurimit në punë kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Inspektimit dhe Marrëdhënieve të Punës në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:

- i. ISHPSSH-ja, nëndrejtori;
- ii. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH);
- iii. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH);
- iv. Biznesalbania;
- v. Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë.

d) Komisioni i ekonomisë dhe i financës kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Buxhetit i dhe Borxhit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:

- i. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përgjegjësi i sektorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Borxhit;
- ii. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH);
- iii. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH);
- iv. Biznesalbania;
- v. Shoqata Shqiptare e Bankave.

dh) Komisioni i shanseve të barabarta, aftësive të kufizuara dhe rinisë kryesohet nga drejtori i Drejtorisë Përgjegjëse për Shanset e Barabarta dhe Aftësitë e Kufizuara në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:

- i. Ministria e Arsimit dhe Sportit, drejtori i drejtorisë përgjegjëse për rininë;
- ii. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH);
- iii. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH);
- iv. Biznesalbania;
- v. Shoqata Shqiptare e Turizmit.

10. Komisionet e përhershme e të specializuara trepalëshe kanë për objekt të shqyrtojnë çështje për fushat e tyre të kompetencës dhe t'ia transmetojnë mendimet e përfundimet e këshillimeve KKP-së, për:

- a) orientimin dhe zbatimin e politikave shtetërore në fushat e veprimtarisë së tyre;
 - b) projektligjet dhe projektvendimet e Këshillit të Ministrave, që kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së tyre;
 - c) çështjet për të cilat KKP-ja u është drejtuar atyre për konsultim dhe mendim.
- Për arritjen e objektivave, çdo komision mund të angazhojë specialistë të kualifikuar.

11. Shfuqizuar.

12. Kryetarët e komisioneve të përhershme e të specializuara trepalëshe caktohen nga ministri përgjegjës për punën nga administrata e kësaj ministrie, sipas fushave që ata mbulojnë. Anëtarët e komisioneve, përfaqësues të institucioneve shtetërore, caktohen nga titullarët e tyre.

13. Anëtarët e komisioneve, përfaqësues të organizatave të punëmarrësve e punëdhënësve (dy për secilën palë) propozohen nga nënkryetarët e palëve.

14. Për funksionimin e KKP-së, në strukturën e ministrisë përgjegjëse për punën ngrihet sekretariati i KKP-së, i përbërë nga tre sekretarë, respektivisht nga një për çdo palë të përfaqësuar në këtë Këshill. Për emërimin e sekretarëve të KKP-së merret edhe mendimi i partnerëve socialë.

14/1. Me përfundimin e mandatit 3-vjeçar (trevjeçar), sekretariati i Këshillit Kombëtar të Punës mbledh dokumentacionin e organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve, që janë të interesuara të jenë pjesë e këtij këshilli, 3 (tre) muaj përpara se të përfundojë mandati. Dokumentacioni i depozituar përbëhet nga vendimi i gjykatës, një kopje e statutit, deklaratimet që kanë të bëjnë me numrin e anëtarëve në subjektet përkatëse, vërtetuar nga kuotizacioni ose vërtetimet noteriale, numri i kontratave kolektive të punës, shtrirja gjeografike e veprimtarisë, si dhe anëtarësimi i tyre në organizatat ndërkombëtare. Një organizatë e punëmarrësve apo e punëdhënësve vlerësohet më e përfaqësuar nëse ka numrin më të madh të kontratave kolektive dhe numrin më të madh të anëtarëve, ndërsa një

organizatë punëdhënësisht vlerësohet nga numri i ndërmarrjeve, numri i punonjësve të punësuar në ndërmarrje dhe numri i degëve/profesioneve.

15. Buxheti i pavarur i KKP-së përbëhet nga:

- a) fondi i dhënë nga buxheti i shtetit;
- b) donacione dhe projekte të ndryshme, të ligjshme.

16. Fondi i dhënë nga buxheti i shtetit për Këshillin Kombëtar të Punës përdoret, kryesisht, për përballimin e shpenzimeve:

- a) të mbledhjeve të KKP-së;
- b) të mbledhjeve të komisioneve të përhershme e të specializuara të tij;
- c) për funksionimin e zyrave shtetërore të pajtimit;
- ç) për organizimin dhe pjesëmarrjen në konferenca trepalëshe;
- d) të seminareve dhe aktiviteteve kualifikuese trepalëshe.

17. KKP-ja bën miratimin paraprak të projektbuxhetit vjetor dhe, nëpërmjet *ministrit përgjegjës për punën*, ia propozon atë për miratim Këshillit të Ministrave.

18. Vendimi nr. 730, datë 6.11.2003 i Këshillit të Ministrave “Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Punës dhe për caktimin e përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave në këtë Këshill”, shfuqizohet.

19. Ngarkohet *ministri përgjegjës për punën* për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama